

DOKUMENTET DHE PROCEDURAT E PRANIMIT NË PROGRAMET MASTER PROFESIONAL

Në mënyrë që të pranohen në një drejtim studimi të ciklit të dytë Master Profesional në UET kandidatët duhet të plotësojnë këto dokumente:

- Formularin e interesimit (shkarkohet online)
- Kopjen e noterizuar të diplomave të nivelit të parë që studenti ka fituar.
- CV-në e kandidatit ku të paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
- Një Letër Interesi (afërsisht 300 fjalë) ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e nivelit Master.
- Një projekt-ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit Master.
- Dy Letra Rekomandimi, të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studime të nivelit Master.
- Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

Procedura e pranimit

Të gjitha dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen në Zyrën e Kontratave. Pas vlerësimit formal të listës së dokumenteve të nevojshme, dokumentacioni i kalon Departamentit përkatës, i cili bën vlerësimin e aplikimeve dhe harton listën e kandidatëve të përzgjedhur. Çdo kandidat i përzgjedhur zhvillon një intervistë me Komitetin Shkencor të programit rreth projektit të zhvillimit të karrierës, në përputhje me fushën e studimit.

Kur Rektori e sheh të arsyeshme ngarkon Fakultetet të organizojnë zhvillimin e një *IQ test* dhe/ose testi seleksionimi. Në këtë rast pranohen ata kandidatë që kalojnë testin e zhvilluar nga Komisioni i veçantë.